



Dje, ditën e martë 26 nëntor, u mbajt, pranë Hotel Rogner në Tiranë, konferenca për shtyp mbi paraqitjen e rezultateve të arritura në edicionin 2024 të "fushatës së mbikqyrjes nga ajri", e organizuar nga Policia e Shtetit shqiptar në bashkëpunimin me Departamentin për Sigurinë Publike të Ministrisë së Brendshme italiane që promovoi, me Guardia di Finanza-n, nismën e bashkëpunimit për të trembëdhjetin vit radhazi.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit shqiptar, Ilir Proda, u pasua nga ajo e Drejtorit të Shërbimit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Policisë (SCIP), Gjeneral Brigade i Guardia di Finanza-s, Giampiero Ianni, dhe e Gjeneral Brigade, Luigi Vinciguerra, Shef i Repartit III të Operacioneve të Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza-s. Në konferencë morën gjithashtu fjalën edhe Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Fabrizio Bucci, dhe Ministri i Brendshëm shqiptar, z. Ervin Hoxha. Të pranishëm në këtë veprimtari Kreu i Qendrës Operative të Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza-s, Gjeneral Brigade Vincenzo Caci, Eksperti italian për sigurinë, Drejtues i Parë i Policisë së Shtetit, Salvatore Gava, Komandanti i Njësisë së Kufirit Detar të Guardia di Finanza-s në Durrës, Major Francesco Della Corte dhe Eksperti i Guardia di Finanza-s, Nënkolonel Giampiero Carrieri.

Lufta ndaj prodhimit të kanabisit dhe trafikut të lëndëve narkotike është objektiv i përbashkët i të dy Vendeve, arsye për të cilën Departamenti i Policisë së Shtetit financon veprimtaritë që bashkërendohen nga Drejtoria e Qendrore e Policisë Kriminale nëpërmjet Shërbimit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Policisë (SCIP), në bashkëpunim me Komandën e Përgjithshme të Guardia di Finanza-s dhe me kontributin shkencor të Konsorciumit Benecon.

Gjatë edicionit 2024 të "fushatës së mbikqyrjes nga ajri", janë identifikuar, çrënjësuar dhe asgjësuar 109.104 bimë kanabisi dhe është vërtetuar prania e 595 plantacioneve të paligjshme.

Krahas luftës ndaj trafikut të lëndëve narkotike, misioni italian në ndihmë të policisë shqiptare është i pranishëm në disa fusha duke u bërë kështu një model i jashtëzakonshëm bashkëpunimi operativ midis forcave të policisë së dy Vendeve çka ka mundësuar arritjen e standarteve gjithmonë e më të larta të sigurisë. Me këtë rast u vu theksi në rëndësinë e luftës ndaj pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme si një faktor kyç për shkatërrimin e organizatave kriminale.

Në fjalën e tij, Ambasadori Fabrizio Bucci falënderoi Policinë e Shtetit shqiptar për arritjen e objektivave të përcaktuara dhe e përgëzoi atë për nivelin e jashtëzakonshëm të bashkëpunimit me forcat italiane të policisë me urimin për arritjen e rezultateve gjithnjë e më të larta në luftën ndaj çdo forme paligjshmërie dhe krimi të organizuar, veçanërisht atij të pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme.

Në përmbyllje të eventit mori fjalën Ministri i Brendshëm, Ervin Hoxha, i cili përcolli një falënderim të veçantë të qeverisë shqiptare për Autoritetet Italiane për mbështetjen e vazhdueshme në ruajtjen e sigurisë, mbështetje kjo e cila shprehet më së miri në veprimtaritë e bashkërenduara nga Drejtoria Qendrore e Policisë Kriminale pranë Departamentit të Sigurisë Publike.

Në mbyllje të kësaj konference, Ministri i Brendshëm Hoxha dhe Drejtori i Përgjithshëm Proda u dorëzuan Gjeneralit Ianni, Gjeneralit Vinciguerra dhe Gjeneralit Caci çertifikata vlerësimi për kontributin e dhënë në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Italisë dhe Shqipërisë në fushën e sigurisë.